



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 333 Nr. i faq./Br.str./No.pg 01

Data/Datum/Date 31/05/2022

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013, nenit 2, nenit 4, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.05.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik parcelën P-71513005-02756-0 në Zonën Kadastrale Krushë e Madhe

1. Me këtë vendim shpallet interes i përgjithshëm publik parcela kadastrale P-71513005-02756-0 në Zonën Kadastrale Krushë e Madhe, në sipërfaqe të përgjithshme prej 197647m² (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dyzet e shtatë metra katror) në vendin e quajtur Paca-Paca, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC UJRAT.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Caktimi i lokacionit për hapësira për biznese", i cili do të shërbejë për zhvillimin e bizneseve në Komunën e Rahovecit dhe më gjerë.
3. Parcela e cekura në pikën 1 të këtij vendimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 të datës 30.05.2013 ka destinim si Tokë Bujqësore Klasa e Bonitetit II.
4. Prona e paluajtshme nuk e ndërronë titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
5. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
6. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin

administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËSNËRAHOVËC

01Nr.333/22
Datë:31.05.2022

